

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Shaqë Curri, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve: A.V.1. nga Prizreni, V.K. nga Prizreni për veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit në bashkëkryerje nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, të akuzuarve A.V.1., V.K. dhe B.K., për shkak të veprës penale të mashtrimit në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK dhe veprës penale të falsifikimit të dokumentit në bashkëkryerje nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.V.1. dhe mbrojtësit të akuzuarës V.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren P.nr.9/2014 datë 01.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 03.03.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohen pjesërisht ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.V.1. dhe V.K., e detyrimisht ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren P.nr.9/2014 datë 01.12.2016 sa i përket ri cilësimit të veprës penale dhe vendimit mbi dënim, ashtu që të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. shpallen fajtor për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), ashtu që për këtë vepër penale të akuzuarve A.V.1. dhe V.K. iu shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarit në afat prej 3 (tri) viteve nuk kryejnë vepër të re penale.

II. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren.

III. Aktgjykimi në pjesën refuzuese ngel i pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin P.nr.9/2014 datë 01.12.2016, i ka shpallur fajtor të akuzuarit: A.V.1. dhe V.K. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK dhe iu ka shqiptuar: të akuzuarit A.V.1. i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 4 (katër) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, të akuzuarës V.K. i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 4 (katër) vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale. Të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. obligohen që të gjitha shpenzimet e procedurës penale të i paguajnë sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor secili në shumën prej 500 (pesëqind) euro të cilën duhet ta paguajnë në afat prej 15 dite prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. E

dëmtuara Institucioni mikrofinanciar “NN” për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil. Të akuzuarit A.V.1., V.K. dhe B.K. në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPP janë liruar nga akuza për veprën penale 261 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar. Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate. Në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPK është refuzuar akuza për të akuzuarit A.V.1., V.K. dhe B.K. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të Falsifikimit të dokumentit nga neni 332 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPK.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet sa i përket dënimit me kusht dhe të njëjtëve për veprën penale Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose autorizimit në bashkëkryerje nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK dhe të akuzuarve t’iu shqiptohet dënim me burgim dhe në pjesën e aktgjykimit nën II të dispozitivit për veprën penale të mashtrimit në bashkëkryerje nga neni 261 par.2 lidhur me par 1 dhe nenin 23 të KPK lëndën ta kthej në rigjykim dhe të bie aktgjykim që të akuzuarit të shpallën fajtor dhe t’iu shqiptoj dënimin e paraparë me ligj.

- Mbrojtësi i të akuzuarit A.V.1. av. P.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 403 par.pika 12 nenit 396 par.7 të KPPK, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit Penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje ose të njëjtin ta ndryshoj në kuptim të pretendimeve ankimore.

- Mbrojtësi i të akuzuarës V.K. av. H.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovon ankesën e ushtruar dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta anulon dhe të mbrojturën e tij ta liroj nga të gjitha pikat e akuzës apo lëndën ta kthen në rigjykim.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I nr.79/17, të dt. 15.02.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovohet ndërsa ajo e mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj qeshjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.V.1. dhe V.K. pjesërisht janë të bazuara ndërsa ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren është e pa bazuar.

Mbrojtësit e të akuzuarve A.V.1. dhe V.K. aktgjykimin e shkallës së parë e atakojnë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke pretenduar dhe atë av. P.P. se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi i njëjti është i pa kuptueshëm, në kundërshtim me arsyetimin e aktgjyimit të sulmuar dhe ka shumë kundërthëniet mes fakteve vendimtare dhe atyre që është bazuar aktgjykimi i sulmuar. Mbrojtësi pretendon se gjykata e shkallës së parë duke e modifikuar dispozitivin e aktgjyimit gjykes në kundërshtim me aktakuzën dhe fjalën përfundimtare në shqyrtim kryesor, të njëjtën e ka ndryshuar pa autorizim identitetin e aktakuzës. Mbrojtësi përshkruan veprimet e të mbrojturit të tij të cilat dalin nga dispozitivi i aktgjyimit e që sipas aktgjyimit këto konsiderohen si tejkalim i kompetencave dhe mos përmbushjes së detyrave zyrtare. Mbrojtësi pretendon se edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij nuk i ka zbatuar me qëllim procedurat e parapara për lejimin e kredive grupore. Përshkruan rolin e të mbrojturit të tij si menaxher ku thotë se veprimet e tij pretendohet se kanë qenë të njëjta sikur të akuzuarës V.K. sepse ata sipas aktgjyimit të atakuar “kanë vepruar në bashkëveprim”. Gjykata nuk ka vërtetu dashjen si element subjektiv, nuk ka identifikuar veprimet individuale të secilit të akuzuar që mund të konsiderohen si bashkëveprime që bëjnë eventualisht element të veprës penale apo kryerjes së mundshme të kësaj veprë në bashkëveprim. Organizata ku ata kanë punuar në vitin 2006 dhe gjatë vitit 2007 nuk kanë pasur rregullore e cila do të definonte saktë mënyrën dhe procedurat e lejimit të kredive. Gjykata thirret në njëfarë manuali apo që mund të jetë një udhëzues apo rregullore por që nuk e përmend administrimin e kësaj si provë dhe veprimin e caktuar konkret të akuzuarve në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë manual. Kjo për faktin se manuali është aprovuar në fund të muajit të VII të vitit 2007, e që në këtë kohë asnjëherë prej të akuzuarve nuk ka qenë në marrëdhënie pune në këtë organizatë. Nuk qëndron fakti se të akuzuarit nuk e kanë bërë identifikimin e drejtë të klientëve por i njëjti është bërë sipas dokumentit të identifikimit ndërsa zotësia për përballimin e kthimit të kredisë është bërë në bazë të veprimtarisë afariste të tij në kuadër të ndonjë veprimtarie të regjistruar apo të pa regjistruar si biznes afarist. Nuk qëndron asnjë fakt i vërtetuar që të akuzuarit të kenë aplikuar pa dijen e personave tjerë në emrin e të cilëve është lejuar kredia. Sa i përket pagesave jashtë lokaleve të institucionit këtë fakt ata e kanë pranuar si të mundshëm por se kjo është bërë në përputhshmëri me politikën financiare të institucionit. Pretendon se sa i përket përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar organizatës të cilën e kanë marrë të akuzuarit tjerë gjegjësisht S.G., B.G.1. dhe A.G.1, ky detyrim paraqet obligim juridiko-civil. Po ashtu mbrojtja ka kundërshtuar edhe ekspertizën pasi që eksperti në fjalë në ndërkohë ka vdekur dhe mbrojtja asnjëherë nuk është pajtuar me ekspertizën në fjalë dhe ka propozuar që të caktohet një ekspert tjetër financiar i cili do të kishte mundësi që të jepte sqarime në pretendimet kundërshtuese të palëve, pasi që në ekspertizë janë përfshi edhe disa kredi të disbursuara përpara periudhës së përfshirë në aktakuzë pra para dhjetorit të vitit 2006 dhe disa gjetje të tjera për të cilat sipas mbrojtjes me një ekspertizë të re do të sqaroheshin.

Mbrojtësi i të akuzuarës V.K. av. H.K. po ashtu pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që nuk janë zbatuar dispozitat e këtij kodi ndërsa ato që janë zbatuar, gjykata i ka zbatuar gabimisht ku si pasojë e të kuptuarit të veprimeve të kundërligjshme të disa të akuzuarve të pa gjykuar në këtë gjykim kanë reflektuar dhe e kanë ndërlidhur gabimisht edhe të mbrojturën e tij e cila sipas mbrojtësit në

asnjë mënyrë nuk ka ndikua te të akuzuarit e tjerë të ndërmarrin veprime të përfituar financiarisht. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit pasi disa prej dëshmive janë lexuar pa i administruar duke u arsyetuar se në gjykimin e mëparshëm janë administruar dhe duke mos marrë parasysh parregullsitë e theksuara nga Gjykata e Apelit. Mbrojtësi pretendon po ashtu se aktgjykimi është përfshirë edhe me shkelje të Ligjit Penal pasi që me këtë aktgjykim gjykata çështjen e ka gjykua pjesërisht duke e ndarë lëndën vetëm për tre të akuzuarit A.V.1., V.K. dhe B.K. edhe pse ishin fillimisht në aktakuzë edhe 5 të akuzuar tjerë, të cilët kanë pranuar se i marrin përsipër kthimin e kredive për dëmin e shkaktuar. Shkelja e Ligjit qëndron për faktin se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të mbrojturës së tij. Mbrojtësi po ashtu pretendon se aktgjykimi është përfshi me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi me asnjë provë nuk është vërtetë se e mbrojtura e tij ka tejkuluar kompetencat e veta dhe obligimet që rrjedhin nga kontrata e punës lidhur me Institucionin financiar “NN”, duke iu përmbajtur të gjitha instruksioneve të menaxherëve të saj dhe udhëheqësve kryesor të institucioneve. Nuk janë dëgjuar udhëheqësit e institucionit financiar që në atë kohë kanë udhëheqë me këtë institucion, dëshmitarin S.M.1 dhe shefin e zyrës operative D.K. të cilët edhe sot e kësaj dite punojnë për këtë institucion.

Kjo gjykatë shqyrtoi ankesat dhe aktgjykimet e shkallës së parë dhe vlerëson se pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pa bazuara. Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe arsyet ku është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Gjykata për secilën pikë të aktakuzës ka dhënë arsyetimin e saj duke i ndërlidhur secilën provë njëra me tjetrën dhe duke dhënë arsyet se ku është bazuar lidhur me ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve. Çështjet e ngritura nga ana e mbrojtësve lidhur me pretendimet e tyre për shkelje esenciale nuk qëndrojnë e për të cilat kjo gjykatë më tepër do ta elaboroj të vërtetimi i gjendjes faktike. Pretendimin e mbrojtësit av. P.P. lidhur me shumën e përfitimeve të akuzuarve tjerë dhe veprimet e të akuzuarve që u kanë mundësuar përfitime të mëdha personave të cekur në aktgjykim, pastaj çështjen se a kanë vepruar të dy të akuzuarit në bashkëveprim, dashjes si element subjektiv, pagesat jashtë lokaleve të institucionit, se të akuzuarit a kanë aplikuar pa dijen e personave të tjerë si dhe pretendimet e mbrojtësit av. H.K. e që kanë të bëjnë me përbërjen e trupit gjykues, dëshmitarët S.M.1 dhe D.K. si dhe ekspertizën financiare, kjo gjykatë i cilëson si të pa bazuara. Nga procesverbalet e shqyrtimeve kryesore shihet se trupi gjykues në përbërje prej Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues dhe anëtarëve Gani Kastrati dhe Shaban Shala, prej fillimit të shqyrtimit gjyqësor kanë qenë prezent deri në shpalljen e aktgjykimit të plotfuqishëm pavarësisht se në shqyrtimet gjyqësore të para kanë qenë disa anëtarë tjerë por se gjatë këtyre shqyrtimeve nuk është administruar asnjë provë. Sa i përket dëshmitarëve S.M.1 dhe D.K., kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka marr aktvendim që dëshmitë e tyre të dhëna në shqyrtimin e mëhershëm gjyqësor, duke pas parasysh se nga shkresa e palës së dëmtuar Institucionit financiar “NN” është arritur përgjigja - njoftimi se këta dëshmitar nuk punojnë më tek e dëmtuara dhe nuk jetojnë në Kosovë, prandaj në bazë të këtyre provave janë plotësuar kushtet që dëshmia e tyre të lexohet në shqyrtimin gjyqësor. Pavarësisht kundërshtimit të mbrojtjes në këtë drejtim kjo nuk paraqet shkelje të dispozitave ligjore duke pas parasysh se këto dy dëshmi nuk janë të vetmet dëshmi në këtë çështje penalo-

juridike pasi që fajësia e të akuzuarve A.V.1. dhe V.K. u vërtetua edhe me prova të tjera. Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dëgjuar dëshmitarët V.H.-P., E.P., M.K., Y.B., M.M., J.Q., Rr.M., L.Q., A.G.2, H.M., M.S., N.K., F.K., F.Z., A.D., F.B., L.G., J.H., A.A.1, A.A.2, A.B.1, K.G., A.G.3., S.M.2, G.K., A.V.2 dhe ka lexuar dëshmitë e S.M.1., D.K., A.G.4., A.G.2, B.K., F.D., A.H., B.G.2., A.B.2, M.J., S.G., A.G., ka administruar raportet kuartale të NN, kontratat e punës për të akuzuarët A.V.1. dhe V.K., letra paralajmëruese për suspendimin e të akuzuarve A.V.1. dhe V.K., letra përfundimtare e pushimit të marrëdhënies së punës për të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. dhe është administruar ekspertiza financiare dhe ankes ekspertiza financiare e përgatitur nga eksperti B.I. dhe është lexuar dëshmia e ekspertit B.I. (pasi që i njëjti ka ndërrua jetë), dhe nga gjitha këto prova materiale dhe jo materiale pa mëdyshje është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën ata janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Nga këto prova nuk është kontestuese se të akuzuarit kanë qenë duke punuar në NN përveç të akuzuarit B.K. dhe atë i akuzuari A.V.1. si menaxher i degës në Malishevë ndërsa e akuzuara V.K. si analiste kreditore në Malishevë dhe është marrë me një numër të caktuar të klientëve në Prizren, e që detyra e sajë ka qenë gjetja e klientëve potencial, promovimi i programit, analizimi i biznesit të klientëve, përgatitja e dokumentacionit dhe propozimi i kredive në komitet, ku së bashku me menaxherin e degës në komitet i kanë aprovuar këto kredi duke vendosur për kërkesat në fjalë e të cilat komitete të kredive janë mbajtur në të gjitha degët e bankës përveç shumave të mëdha që kalojnë kompetencat e menaxherit. Sipas rregullores së brendshme të “NN” gjatë vitit 2006 për kreditë grupore ka qenë e mundur me u dhënë kredia në vend të biznesit ndërsa në vitin 2007 klienti është dashtë që personalisht që të jetë në zyrat e “NN”-s me dokumente personale për ta tërhequr kredinë ndërsa për marrjen e kredisë secili anëtar i grupit ka pasur obligim të nënshkruaj personalisht dokumentin e kredisë dhe tërheqjen e kredisë. Kredit grupore kanë kërkuar pjesëmarrjen e minimum tre anëtarëve të grupit pa kolateral dhe është dhënë në baza solidare në mes tyre ashtu që në rast se një anëtarë i grupit nuk e paguan kredinë atëherë anëtarët tjerë duhet ta mbulojnë borxhin e atij anëtari. Parregullsitë deri në vitin 2006-2007 nuk janë vërejtur derisa janë paraqitur vonesat e kredive dhe pastaj janë bërë vizitat e klientëve e ku njëri prej tyre ka deklaruar se është përgjegjës për disa anëtarë të grupeve të cilët kanë marrë kredi dhe nga kjo deklaratë ka dal se ai nuk ka pas të drejtë që me marr kredi në emër të personave tjerë. Në vitin 2007 është bërë auditimi i brendshëm në NN dhe nga ky auditim ka rezultuar me mos zbatim të kritereve të kreditimit nga ana e të akuzuarve do të thotë nuk është veprua me procedurat e kreditimit. Këto të gjetura kanë qenë moszbatimi i rregullores së brendshme të kreditimit- dhënia e kredisë për personat të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet për marrjen e kredisë, pastaj dhënia e kredisë për klient jo ekzistues të cilët nuk kanë aplikuar për kredi që do të thotë se kredia është dhënë pa dijeninë e klientëve, përfundim ky të cilin auditori e ka gjetur gjatë kontrollimit të dokumentacionit të klientëve, takimit me klient, takimin me tre përgjegjësit për mbledhjen e klientëve si dhe nga deklaratat e klientëve se të njëjtit nuk kanë marrë kredi, se të njëjtit nuk janë nënshkruar të marrëveshjes për kredi ndërsa disa prej tyre kanë deklarua se e kanë nënshkruar marrëveshjen porse kanë marrë parat vetëm për nënshkrim. Zyrtarët e NN janë takuar me A.G.1., i cili ka marr shumë të caktuar të kredive mes personave tjerë dhe ka deklarua se është posedues i 12 apo 13 kredive në atë kohë që i ka marr me klient të cilët kanë nënshkrua dhe një numër të klientëve që nuk kanë qenë prezent por kanë marrë kredi nga punëtorët tani të akuzuarit A.V.1.1. dhe V.K.. Në këto parregullsi kanë qenë të përfshirë edhe B.G.1., S.G. dhe djali i S.G. B.G.3., deklaratat e të cilit është e njëjtë si ajo e A.G.1. e që në

deklaratën e tyre të dhënë në NN në gusht të vitit 2007 kanë pranuar si detyrim ndaj NN diku rreth 890.000,00 euro. Të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. si persona të autorizuar për dhënien e kredive në grup dhe kredive individuale në NN së bashku me klientët e autorizuar A.G. , B.G.1., S.G. dhe B.G.3. në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë dëmtua NN-n në shumë prej 889.637.25 euro ashtu që kanë formuar grupe apo persona përgjegjës dhe atë A.G.1. në total 93 klient të mashtruar, B.G.1. 283 klientë të mashtruar, S.G. 346 klientë të mashtruar ku përsëritën emrat e klientëve të njëjtë në grupe të ndryshme dhe me emërtime të ndryshme, e ku në mesin e këtyre personave të mashtruar janë edhe emrat e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtimin kryesor. Sipas mendimit të ekspertizës përgjegjësia për shpërdorim të detyrës zyrtare bie jo vetëm në personat përgjegjës tani të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. por edhe në menagjimentin e lartë të cilët kanë punuar dhe vepruar në atë kohë. Se përgjegjësia materiale financiare bie mbi klientët e autorizuar të tyre dhe atë A.G.1. me 137.579,74 euro, B.G.1. me 308.028,96 euro dhe S.G. me 444.028,55 euro duke e dëmtuar institucionin NN në Prizren me shkaktim të humbjes prej 889.637,25 euro. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë thekson se vetë fakti se të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. në kundërshtim me rregullat e bankës kanë kryer veprimet kreditore duke përpiluar pa prezencë dhe vullnetin e kredi marrësve, kanë dhënë kredi për personat të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet për marrjen e kredisë, dhënia e kredisë për klient jo ekzistues të cilët nuk kishin aplikua për kredi dhënia e kredisë pa dijen e klientëve, mënyra e pagesës nga të njëjtit vetëm për udhëheqësit e grupit, vërteton se të njëjtit kanë shkelur autorizimet e veta si zyrtare kanë shkelur-tejkaluar autorizimet e veta si zyrtar të NN-s duke e dëmtua institucionin financiar në shumën si më lartë. Kjo vërtetohet edhe me pranimin e veprimeve nga ana e të akuzuarve A.G.1., B.G.1. dhe S.G. para zyrtarëve të NN se parat ishin të destinuara për ta vet dhe se në këtë mënyrë i kanë nxjerr parat nga NN dhe kanë dhënë deklaratë me shkrim në prezencë edhe të akuzuarit A.V.1. se i marrin përsipër të gjithë shumën që konsiderohet dëm i shkaktuar NN-s. Sa i përket pretendimit të mbrojtësve e lidhur me ekspertizën financiare, ku të njëjtit e kundërshtojnë ekspertizën duke kërkuar ekspertizë të re por edhe për faktin se eksperti financiar në fjalë në ndërkohë ka vdekur, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret ekspertiza është në përputhje edhe me provat tjera të administruara në shqyrtimin kryesor e të cilat u cekën edhe më lartë, e që për këtë çështje penalo-juridike e rëndësishme është se është shpërdoruar detyra zyrtare duke i shkaktuar dëm palës së dëmtuar, ndërsa pretendimet lidhur me shumën e saktë që mund të jetë eventualisht kontestuese ajo do të vërtetohet me rastin e realizimit të kërkesës pasuroro-juridike nga ana e palës së dëmtuar në kontest juridiko-civil. Nga të gjitha këto që u thanë më lartë ku u demantuan pretendimet e të akuzuarve se nuk janë fajtor për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, me të drejtë gjykata e shkallës së parë të njëjtit i ka shpall fajtor dhe i ka gjykuar si në aktgjykim të shkallës së parë.

Sa i përket veprës së dytë penale e që ka të bëjë me veprën penale të Mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK-së, kjo gjykatë vlerësoi ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe të njëjtën e konsideron si të pa bazuar duke vërtetuar se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka gjetur se të akuzuarit A.V.1., V.K. dhe B.K. nuk janë fajtor për kryerjen e veprës penale të Mashtrimit. Prokuroria në ankesë pretendon se ka prova të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohen veprimet inkriminuese të akuzuarve në bashkëveprim në mes tyre ku duke i fshehur faktet kanë mashtruar të dëmtuarit duke ju marrë lejet e njoftimit gjegjësisht kopjet e tyre, duke përgatit dokumentacion për të dëmtuarit pa dijeninë e tyre e disa duke i vënë në lajthim se

gjëja këto dokumente do të ju shërbejnë për dhënien e ndihmave falas ndërsa në anën tjetër janë regjistruar si kredi marrës, dhe se të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. kanë qenë në marrëveshje paraprake me të akuzuarin B.K. dhe me të akuzuarit tjerë të cilët gjenden në arrati. Gjykata e Apelit në tersi e pranon gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë gjegjësisht arsyetimin e dhënë lidhur me këtë veprë penale dhe vlerëson se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale pasi që të gjithë dëshmitarët e dëgjuar kanë vërtetu se nuk kanë qenë të akuzuarit ata që kanë komunikuar me ta duke iu kërkuar letërnjoftimet por se ato ua kanë kërkuar të akuzuarit A.G.1., S.G. dhe B.G.1., të cilët edhe i kanë gjetur këta klient-dëshmitar të dëgjuar e në disa raste vetëm u kanë marrë letërnjoftimet duke formuar grupe për marrjen e kredive grupore, po ashtu të njëjtit ua kanë marrë letërnjoftimet duke u dhënë shpërblim të vogël në para por pa ua shpjeguar se për çka po ua marrin letërnjoftimet pra të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. nuk kanë pasur komunikim me këta dëshmitar përveç që kanë qenë prezent kur janë dhënë nënshkrimet nga ta, e siç e vlerëson edhe vetë gjykata e shkallës së parë këto veprime të akuzuarve A.V.1. dhe V.K. janë inkorporuar në veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit nga neni 339 kpar.3 e që lidhet me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK e për të cilën veprë penale ata janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Ndërsa sa i përket të akuzuarit B.K. edhe për të njëjtin nuk është vërtetuar me asnjë provë se ka kryer veprën penale të mashtrimit pasi që një gjendje e tillë faktike u vërtetua nga dëshmitarët F.Z., Xh.R. dhe A.D. të cilët kanë deklaruar se ja kanë dhënë letërnjoftimin dhe kanë nënshkruar dokumentet që B.K. të merr kredi ndërsa pas kësaj të akuzuarit A.V.1. dhe V.K. në zarf ia kanë dhënë parat B.K. dhe se dëshmitarët për nënshkrimin si garantues kanë deklaruar se nuk kanë qenë të mashtruar nga i akuzuari B.K..

Ndërsa sa i përket ricilsimit të veprës penale gjykata të njëjtën e ricilsoi detyrimisht e sipas detyrës zyrtare, për faktin se vepra penale nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 23 të KPK, e cila veprë penale ka qenë e paraparë me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës dhe i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale është Kod më i pa favorshëm për të akuzuarit në raport me të njëjtën veprë penale që është parapa me Kodin Penal të Republikës së Kosovës gjegjësisht nenin 422 par.1 të KPRK, për faktin se neni 339 par.3 i KPK për këtë veprë penale ka paraparë dënimin me burgim prej 1 deri në 8 vjet ndërsa neni 422 par.1 i KPRK, parasheh dënimin me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet andaj gjykata e shkallës së parë duke aplikuar nenin 3 të KPRK-së, Ligjin më të favorshëm, ndryshoi detyrimisht aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me cilësimin e veprës penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e këtij aktgjykimi.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë, nuk janë të bazuara. Prokuroria në këtë rast nuk ka cekur ndonjë rrethanë të re e që kishte me ndikuar në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit, por thekson se nuk ka marrë për bazë asnjë nga rrethanat rënduese të parapara me Ligj duke arsyetuar gjykata se nuk ka gjetur rrethana rënduese e të cilat kanë ekzistuar ndërsa i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat fare nuk kanë

ekzistuar nga se të akuzuarit me shkaktimin e dëmit kanë përvetësua në mënyrë të kundërligjshme ngritje të hyrave personale të tyre gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare duke iu rritur paga si pasojë e shtimit të klientëve në mënyrë të rrejshme dhe në kundërshtim me Ligjin. Ndërsa mbrojtësi av. P.P. edhe pse e ka cekur si bazë ankimore vendimin mbi dënim të njëjtën nuk e ka elaborua, e po ashtu edhe mbrojtësi i të akuzuarës V.K. avokati H.K. ka cekur bazën ankimore me arsyetim se vendimi mbi dënim është i kundërligjshëm, ndërsa Gjykata e Apelit, të njëjtat i shqyrtoi dhe meqë ri cilësoi veprën penale, të akuzuarve u shqiptoi një dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë si dhe duke pas parasysh edhe kohën relativisht të gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.68/2017, më 06.03.2017

Procesmbajtësi,
Shaqë Curri

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____